



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 59 datë 26.10 2020

“Për krijimin e landfillit të ri për mbetjet inerte dhe çështje të tjera lidhur me depozitimin, administrimin, perpunimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane .”

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9/1/ 1.2/c; neni 64/c, VKB Nr.23 dt.24.04.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Vau-Dejës”; të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjit Nr.10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”i ndryshuar; VKM Nr.575 dt.24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”; në vijim të përgjigjeve të shkresës dërguar nga Prefekti i Qarkut Shkodër Nr. 645/1 prot, datë 30.09.2020, me propozim të Shoqërisë “Ndërkomunale Bushat Sh.a”,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Organet e Shoqërisë (Asambleja e Përgjithshme) do të vendos mbi politikat tregtare të shoqërisë ndaj operatorëve, si miratimi për rishikimin e Kontratës së shërbimit “Për depozitimin, Administrimin, perpunimin dhe riciklimin e Mbetjeve urbane ne vend - depozitimin (Lendfill) Bushat, Vau Dejes” me pale; Shoqeria Nderkomunale Bushat dhe Shoqeria “Becker Albania sh.a” .
2. Shoqëria Ndërkomunale Bushat të nisë procedurat administrative për krijimin e Vend-depozitimit të landfillit te ri per mbetjet Inerte, të miratuar në Planin e Përgjithshëm vendor te Bashkise Vau-Dejës miratuar me VKKT nr.3 datë 27.4.18 ”Rregullorja vendore e planit të përgjithshëm vendor/Njësi me pasaporte BU-In-012, kaluar prona me VKM nr 68 date 28.01.2008 “ Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër”
3. Landfilli i ri per mbetjet inerte do te jete ndertuar dhe do të funksionojë me vehte ne perputhje me nenit 43 te ligjit Nr.10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të

- mbetjeve” i ndryshuar dhe pikës 21 të VKM-së Nr.575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”,
4. Të njoftohen subjektet e interesuara lidhur me efektet ligjore të këtij Vendimi.
 5. VKB Vau-Dejes Nr.50 date 25.08.2020 revokohet.
 6. Ky vendim hyn ne fuqi sipas percaktimeve te nenit 55/6 e ligjit nr.139/2015 ‘Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar

ZV/ KRYETAR

Ervis SHIMAJ

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA



Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 30.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT

Nr. _____

Datë _____ 2020

Drejtuar: Prefektit të Qarkut Shkoder

Lënda: Sqarim per depozitim e VKB-se Nr. 59 datë 26.10.20, nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës

Baza Ligjore : Ligji Nr 107/2016 “ Për Prefektin”, neni 16, pika 2/b , ii)

Të nderuar,

Në vijim të komunikimeve tona të mëparshme dhe mbledhjes së datës 26.10.2020 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës ku është marrë vendimi nr. 59, datë 26.10.20 me objekt “Per rishikim e Kontrates se Sherbimit “Për depozitim administrimin menaxhimin e mbetjeje urbane”; miratimin e venddepozitimit për krijimin e landfillit të ri për mbetjet inerte dhe miratimin për shërbimin e depozitimit të mbeturinave teknologjike”, kërkojmë tju informojmë se:

Në komunikimin e fundit shkresor me Prefekturën e Qarkut, shkresën Nr. Prot 645/3, datë.30.09.2020, janë renditur argumenta të cilat sugjerojnë në terma të nenit 16 të ligjit 107/2016 “Për prefektin e Qarkut” ndryshime konkrete në VKB. Për sa më sipër, në respekt të opinionit ligjor të Prefekturës, Këshilli Bashkiak ka riparë elementët e përcaktuar në shkresën tuaj duke plotësuar relacionin shoqërues VKB-së nga Administrata e Bashkisë Vau Dejës sipas kërkesës suaj.

Kontrata ndërmjet Shoqërisë Ndërkomunale Bushat dhe operatorit Becker, nuk është kaluar për konfirmim në këshillin Bashkiak, por do të vlerësohet dhe lidhet nga palët në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Këshilli Bashkiak ka dhënë miratimin për rishikimin e kontratës nga Shoqëria.

Është bërë përcaktimi i sakt i venddepozitimeve të landfillit të ri të për mbetjet Inerte parashikuara në VKB, të cilat përputhet me planin e Përgjithshëm vendor sipas të cilit: “Rregullorja vendore e planit të përgjithshëm vendor / Njësi me pasaportë BU-In-012 / Përcakton përdorimin e njësisë si landfill, në të cilën propozohet konsolidimi i përdorimit ekzistues dhe gjelbërimi i kurorës së kodrës”. Landfilli i ri për mbetjet inerte do të jetë ndërtuar dhe do të funksionojë më vete, në përputhje me nenin 43 të ligjit 10463/2011, të

cituar nga ju, sipas projektit. Më tej, Shoqëria do të procedojë me lejet përkatëse sipas legjislacionit në ministrinë e linjës, vetëm pas miratimit të të cilave do të jetë i mundur fillimi i funksionimit normal të landfillit. Shprehja e vendimit të këshillit nuk kërkon në asnjë parashikim ligjor miratim paraprak nga organe të tjera.

Vendosja e çmimit mbetje/ton, përfshin dy momente: Caktimin e çmimit që operatorët e jashtëm do të paguajë në favor të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat dhe raporti se sa nga ky cmim total do të kalohet në favor të shoqërisë Becker. Per sa më sipër në përgjigje të shkresës së prefektit të qarkut, organet e Shoqërisë do të vendosin vetë mbi cmimin e ri, pa miratimin e Këshillit Bashkiak.

Me respekt,

KRYETAR

MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT

SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. 02 datë 15.10 2020

“Për krijimin e landfillit të ri për mbetjet inerte dhe çështje të tjera lidhur me depozitimin, administrimin, perpunimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane .”

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9/1/ 1.2/c; neni 64/c, VKB Nr.23 dt.24.04.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Vau-Dejës”; të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjit Nr.10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”i ndryshuar; VKM Nr.575 dt.24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”; në vijim të përgjigjeve të shkresës dërguar nga Prefekti i Qarkut Shkodër Nr. 645/1 prot, datë 30.09.2020, me propozim të Shoqërisë “Ndërkomunale Bushat Sh.a”,

VENDOSI

1. Organet e Shoqërisë (Asambleja e Përgjithshme) do të vendos mbi politikat tregtare të shoqërisë ndaj operatorëve, si miratimi për rishikimin e Kontratës së shërbimit “Per depozitimin, Administrimin, perpunimin dhe riciklimin e Mbetjeve urbane ne vend - depozitimin (Lendfill) Bushat, Vau Dejes” me pale; Shoqeria Nderkomunale Bushat dhe Shoqeria “Becker Albania sh.a” .
2. Shoqëria Ndërkomunale Bushat të nisë procedurat administrative për krijimin e Vend-depozitimit të landfillit te ri per mbetjet Inerte, të miratuar në Planin e Përgjithshem vendor te Bashkise Vau-Dejës miratuar me VKKT nr.3 datë 27.4.18 ”Rregullorja vendore e planit të përgjithshëm vendor/Njësi me pasaporte BU-In-012, kaluar prona me VKM nr 68 date 28.01.2008 “ Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër”
3. Landfilli i ri per mbetjet inerte do te jete ndertuar dhe do të funksionojë me vehte ne perputhje me nenit 43 te ligjit Nr.10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të

të mbetjeve” i ndryshuar dhe pikës 21 të VKM-së Nr.575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”,

4. Të njoftohen subjektet e interesuara lidhur me efektet ligjore të këtij Vendimi.

5. VKB Vau-Dejes Nr.50 date 25.08.2020 revokohet.

6. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55/6 e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar

KRYETAR

MARK BABANI



Sektori i Asistencës Ligjore

Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore

Konceptoi

Përgjegjës

Kristinë Shtatri

Miratoi:

Drejtor:

Kristi Bajo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT

SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

Nr. 02/1 Prot.

DATA 15.10.2020

RELACION

“Për krijimin e landfillit të ri për mbetjet inerte dhe çështje të tjera lidhur me depozitimin, administrimin, perpunimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane .”

Mbështetur në Kërkesën e Shoqërisë Becker, dhe kërkesën e Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sh.a , në vijim dhe të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, i propozojmë Këshillit Bashkiak të vendos lidhur me ndryshimet në çështjet si vijon:

1. Baza ligjore mbi të cilën bëhet ky relacion

Ligj Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;

VKM Nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”;

VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”;

VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

2. Objektivat që synohet të arrihen.

Qëllimi i këtij vendimi konsiston në sfidën që ka Bashkia Vau i Dejës dhe Shoqëria “Ndërkomunale Bushat sha” për të ofruar nëpërmjet Landfillit të Bushatit shërbimin e grumbullimit të mbetjeve nga i gjithë territori i saj duke optimizuar koston e grumbullimit

nëpërmjet hartimit të nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit dhe perpunimit të mbetjeve për të krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e buxheteve në fushën e grumbullimit dhe perpunimit të mbetjeve, por dhe duke iu përgjigjur kostove reale të shërbimit si dhe proporcionalitetit të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe kontraktore.

3. Vlerësimi i vendimit në raport me programin e zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës

Strategjia e Bashkisë Vau i Dejës në grumbullimin 100% të mbetjeve të zonave urbane dhe rurale dhe plotësimi i standartit për ofrimin e shërbimit të menaxhimit për grumbullimin e mbetjeve dhe më pas për të përcaktuar hapat e mëtejshme për trajtimin e ketyre mbetjeve.

4. Argumentimi i projekt vendimit lidhur me domosdoshmërinë e marrjes së këtij vendimi dhe problematikat dhe efektet e pritshme

Kompania Becker dhe Shoqëria Ndërkomunale Bushat sh.a me anë të kërkesës për rishikimin e çmimit të kontratës së shërbimit të lidhur më datë 28.04.2017 ka bërë një analizë studimore duke paraqitur një pasqyrë mbi ndryshimet e kostove dhe dispozitave ligjore që kanë influencuar në kontratën aktuale mes palëve. Pas verifikimeve tona kemi vlerësuar se:

Së pari, Këshillit Bashkiak i kërkohet të miratojë rishikimin e kontratës së shërbimit, “Per depozitimin, Administrimin, perpunimin dhe riciklimin e Mbetjebve urbane ne vend - depozitimin (Lendfill) Bushat, Vau Dejes” me pale; Shoqeria Nderkomunale Bushat sh.a, me seli ne Bushat Vau Dejes, lidhur me ketë problem janë zhvilluar disa takime si dhe është shprehur dhe Asambleja e Përgjithshme e shoqërise me vendim , ndaj në vijim të nenit 8, pika 2 e kontratës është rënë dakort që ekzistojnë kushtet për të vendosur lidhur me disa ndryshime në kontratë që lidhen me ndryshimin e cmimit përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve, etj.

Së dyti, gjatë periudhës se monitorimit të kontratës nga ana jone dhe prezantimit të problemit nga kjo Shoqeri kemi konstatuar që ka kërkesa të shumta të subjekteve të ndryshme **për dërgimin e inerteve pranë Lanfillit të Bushatit** . Bazuar Ligjin nr 10463 datë 22.09.2011 “Per menaxhimin

e integruar të mbetjeve” Kreu VII Neni 43 pika 5, në VKM nr Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” pika 19 “*Landfillet e mbetjeve inerte mund të jenë landfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose landfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit ku do të ndërtohet landfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij.*” kërkojmë riorganizimin e landfillit të Bushatit brenda sipërfaqes se miratuar prej 23 ha për të bërë të mundur depozitimin dhe përpunimin e inerteve pranë këtij landfilli në një sasi deri 500 ton në ditë, duke parashikuar dhe prespektiven. Ne landfillin e përcaktuar për mbetjet urbane do të përfshihen mbetjet si më poshtë:

- a. *Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte materiale elektrike hidraulike nga prishjet etj)*
- b. *Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (dhera dhe shtuf)*
- c. *Mbetjet që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave si edhe nga trajtimet fiziko – kimike të mineraleve*
- d. *Mbetje nga proceset termike*
- e. *Mbetje nga pastrimi i lumenjve , digave dhe kaskadave të hidrocentraleve*
- f. *Mbetje nga procesi i dekompostimit të mbeturinave të krijuara nga hapsirat e gjelbermit etj*

Për ndërtimin e tij kërkohej që brenda zones të miratuar prej 23 ha të përcaktohet vendi i landfillit i dedikuar vetëm për mbeturinat urbane të sipërshënuara. Gjithashtu kërkojmë kontributin e Bashkisë Vau i Dejës për hartimin e projektit të plotë për ndërtimin e këtij landfilli shoqëruar me një studim fisibiliteti dhe analize financiare për kostot e ndërtimit të landfillit dhe tarifën për kryerjen e këtij shërbimi. Kërkohej gjithashtu financimi i zbatimit të projektit nga Bashkia Vau i Dejes. Për tu përcaktuar se si ky shërbim do të menaxhohet nga Shoqeria Nderkomunale Bushat.

Së treti, kemi kërkesa të shumta të subekteve të ndryshme për dërgimin e mbetjeve teknologjike (jo toksike) pranë këtij landfilli në një sasi deri 200 ton në ditë për të cilën i duhet duhet të riorganizohet sipërfaqja prej 23 ha. Për tu përcaktuar se si ky shërbim do të delegohet nga porositësi tek operatori me kushtet e detajuara në një kontratë dy palëshe.

Për sa më sipër, i kërkohet Këshillit Bashkiak të vendos lidhur me pikat , si më poshtë:


1. Organet e Shoqërisë (Asambleja e Përgjithshme) do të vendos mbi politikat tregtare të shoqërisë ndaj operatorëve, si miratimi për rishikimin e Kontratës së shërbimit “Për depozitimin, Administrimin, perpunimin dhe riciklimin e Mbetjeve urbane ne vend - depozitimin (Lendfill) Bushat, Vau Dejes” me pale; Shoqeria Nderkomunale Bushat dhe Shoqeria “Becker Albania sh.a” .
2. Shoqëria Ndërkomunale Bushat të nisë procedurat administrative për krijimin e Vend-depozitimit të landfillit te ri per mbetjet Inerte, të miratuar në Planin e Përgjithshem vendor te Bashkise Vau-Dejës miratuar me VKKT nr.3 datë 27.4.18 ”Rregullorja vendore e planit të përgjithshëm vendor/Njësi me pasaporte BU-In-012, kaluar prona me VKM nr 68 date 28.01.2008 “ Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër”
3. Landfilli i ri per mbetjet inerte do te jete ndertuar dhe do të funksionojë me vehte ne perputhje me nenit 43 te ligjit Nr.10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar dhe pikës 21 të VKM-së Nr.575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”,
4. Të njoftohen subjektet e interesuara lidhur me efektet ligjore të këtij Vendimi.

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT

SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Drejtor : Kristi Bajo

Përgjegjës Sektori : Kristinë Shtatri



REPUBLIKA E SHQIPERISE

SUBJEKTI: " NDERKOMUNALE BUSHAT " SHA NIPT: K87108002A

ADRESEN: BUSHAT,SHKODER TEL: +355(0)693472448

EMAIL:nderkomunalebushat2019@hotmail.com

Nr. 28 Prot



Nr. 5880 Prot
DT. 05.10.20

Bushat 01.10.2020

DREJTUAR: ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË NDERKOMUNALE BUSHAT

PËR DIJENI: KËSHILLIT MBIKQYRËS TË SHOQËRISË NDERKOMUNALE BUSHAT

OBJEKTI: RELACION MBI RISHIKIMIN E TARIFES TË SHËRBIMIT PËR DEPOZITIMIN ADMINISTRIMIN MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE; MIRATIMIN E ZONAVE PËR KRIJIMIN E LANDFILLIT TË RI PËR MBETJET INERTE DHE MBETJET TEKNOLOGJIKE DHE TARIFEN PARAPRAKE TË SHËRBIMIT PËR TO NË LANDFILLIN E BUSHATIT

Mbështetur në Kërkesën e Shoqërisë Becker, por dhe në vlerësimin e Administratori të Shoqërisë, sipas Nenit 135, pika 2 a) të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE, (I ndryshuar) ku citohet: "Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: a) përcaktimin e politikave tregtare" kërkojmë nga Asambleja e Përgjithshme të mbledhet në datë 15.10.2020, për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me problematikat e poshtë referuara.

1. Baza ligjore mbi të cilën bëhet ky relacion

Ligj Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar;
VKM Nr. 809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi";



VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostove menaxhimit të integruar të mbetjeve”;

VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

2. Objektivat që synohet të arrihen.

Qëllimi i këtij vendimi konsiston në sfidën që ka Bashkia Vau i Dejës dhe Shoqëria “Ndërkomunale Bushat sha” për të ofruar nëpërmjet Landfillit të Bushatit shërbimin e grumbullimit të mbetjeve nga i gjithë territori i saj duke optimizuar koston e grumbullimit nëpërmjet hartimit të nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve për të krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e buxheteve në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve, por dhe duke iu përgjigjur kostove reale të shërbimit si dhe proporcionalitetit të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe kontraktore.

3. Vlerësimi i vendimit në raport me programin e zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës

Strategjia e Bashkisë Vau i Dejës në grumbullimin 100% të mbetjeve të zonave urbane dhe rurale dhe plotësimi i standartit për ofrimin e shërbimit të menaxhimit për grumbullimin e mbetjeve dhe më pas për të përcaktuar hapat e mëtejshme për trajtimin e ketyre mbetjeve.

4. Argumentimi i projekt vendimit lidhur me domosdoshmërinë e marrjes së këtij vendimi dhe problematikat dhe efektet e pritshme

Kompania Becker me anë të kërkesës për rishikimin e çmimit të kontratës së shërbimit të lidhur më datë 28.04.2017 ka bërë një analizë studimore duke paraqitur një pasqyrë mbi ndryshimet e kostove dhe dispozitave ligjore që kanë influencuar në kontratën aktuale mes palëve. Pas verifikimeve tona dhe përlllogaritjeve kemi vlerësuar se:

1. Si pasojë e rritjes së volumit të mbetjeve në landfill nga Kompania BECKER sha kemi rritje të numrit të punonjesve në dispozicion të kësaj kontrate nga 17 punonjës në 25 punonjës dhe rritjen e shpenzimeve për to si rezultat i rritjes të nivelit minimal të pagës me VKM Nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” nga 24.000 lekë në 2017 në 26.000 në janar të 2019. Pra kemi një rritje të nivelit minimal të pagës në masën 8.3%
2. Në bazë të Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar. Kompania kontraktuese BECKER shpk ka qenë e detyruar të kryejë një sërë investimesh në Landfill për të përmbushur kërkesat që vijnë nga respektimi i mjedisit dhe bazuar në këto investime ka marrë dhe lejet përkatëse. Një sërë procesesh për trajtimin e mbetjeve kanë mbetur pa realizuar si pasojë e kostos shumë të lartë të përpunimit të

mbetjeve dhe tarifave shumë të ulta që janë miratuar për trajtimin e tyre në këtë Landfill. Rritja e shpenzimeve nuk ka ardhur si pasojë e vullnetit të palëve por është e lidhur me faktorë të jashtëm të tillë si ndryshimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve të integruara .

3. Në kontratën e lidhur me këtë kompani nuk janë parashikuar kostot e larta të shërbimeve që kërkohen gjatë periudhës së sezonit turistik ku numri i banorëve në dy qarqet rritet ndjeshëm sikundër kemi një rritje të konsiderueshme të mbetjeve që sillen për tu trajtuar në Landfill. Për këtë periudhë për të përballuar fluksin e madh të mbetjeve operatorit i është dashur të marrë me qira nga të tretë automjete të ndryshme dhe të punësojë punonjës sezonalë të cilët janë të angazhuar të punojnë 24 orë në ditë. Puna gjatë kësaj periudhe në ditët e festave zyrtare dhe në oraret e natës me ndryshimet ligjore të sipërcituara ka rritur ndjeshëm koston e shërbimit
4. Detyrimi për rishikimin e koston së përpunimit të mbetjeve urbane vjen nga ligji dhe nga VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” e dalë në varësi të këtij ligji. Në bazë të kësaj VKM-je një zë shumë të rëndësishëm në llogaritjen e koston së menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane është kostoja e përpunimit në Landfill. Me anë të këtij akti Keshilli i Ministrave ka vendosur miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, sipas dokumenteve "Udhëzues për llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbetjeve" dhe "Modelet për llogaritjen e tarifave për menaxhimin e mbetjeve", përkatësisht, shtojcat 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi. Akti është urdhëruar dhe shprehimisht organi më i lartë i qeverisë ka vendosur që; *“Ngarkohen të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi”*.
5. Gjatë periudhës së monitorimit të kontratës nga ana jone dhe prezantimit të problemit nga kjo Shoqeri kemi konstatuar që ka kërkesa të shumta të subjekteve të ndryshme **për dërgimin e inerteve pranë Lanfillit të Bushatit** . Bazuar Ligjin nr 10463 datë 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve” Kreu VII Neni 43 pika 5, në VKM nr Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” pika 19 *“Landfillet e mbetjeve inerte mund të jenë landfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose landfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit ku do të ndërtohet landfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij.”* kërkohet riorganizimin e landfillit të Bushatit brenda sipërfaqes së miratuar prej 23 ha për të bërë të mundur depozitimin dhe përpunimin e inerteve pranë këtij landfilli në një sasi deri 500 ton në ditë, duke parashikuar dhe prespektiven. Në landfillin e përcaktuar për mbetjet urbane do të përfshihen mbetjet si më poshtë:



- a. Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte materiale elektrike, hidraulike nga prishjet etj)
- b. Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (dhera dhe shtuf)
- c. Mbetjet që dalin nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave dhe karrierave si edhe nga trajtimet fiziko – kimike të mineraleve
- d. Mbetje nga proceset termike
- e. Mbetje nga pastrimi i lumenjve , digave dhe kaskadave te hidrocentraleve
- f. Mbetje nga procesi i dekompostimit te mbeturinave te krijuara nga hapsirat e gjelbermit etj

Për ndërtimin e tij kërkohej që brenda zones të miratuar prej 23 ha të përcaktohet vendi i landfillit i dedikuar vetem për mbeturinat inerte të sipërshënuara. Gjithashtu kërkojmë kontributin e Bashkisë Vau i Dejës për hartimin e projektit të plotë për ndërtimin e këtij landfilli shoqëruar me një studim fisibiliteti dhe analize financiare për kostot e ndërtimit të landfillit dhe tarifën për kryerjen e këtij shërbimi. Kërkohej gjithashtu financimi i zbatimit të projektit nga Bashkia Vau i Dejës. Për tu përcaktuar se si ky shërbim do të menaxhohet nga Shoqëria Nderkomunale Bushat.

6. Po kështu kemi kërkesa të shumta të subjekteve të ndryshme për dërgimin e mbetjeve teknologjike (jo toksike) pranë këtij landfilli në një sasi deri 200 ton në ditë për të cilën i duhet duhet të riorganizohet sipërfaqja prej 23 ha. Për tu përcaktuar se si ky shërbim do të delegohet nga porositësi tek operatori me kushtet e detajuara në një kontratë dy palëshe.

Për të gjitha kërkesat e përshkruara më sipër dhe bazuar në VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” pika 1.4 “Kostot e trajtimit mund të jenë subjekt i ndryshimit, bazuar në sasinë e mbetjeve që shkon në fushëdepozitim dhe në ndryshimin e shërbimeve që kryhen në të”_shoqëria Becker ka bërë një analizë të kostos minimale të përpunimit të mbetjeve duke përfshirë në këtë kosto edhe detyrimet që ajo ka në bazë të ligjit për ndikimin në mjedis sa i takon mirëmbajtjes në Landfill. Pas analizës financiare të propozuar nga kjo Kompani mbi shpenzimet aktuale dhe të ardhurat aktuale në këtë landfill , tabela e kërkeses për ndryshimin e tarifave paraqitet si më poshtë:

Emertimi	Vlera ne ton total/pa tvsh	Porositësi Lekë/ton pa TVSH	Operatori lekë/ton pa TVSH	Ne % Porositësi kundrejt totalit
Mbetje Urbane	1500	300	1200	20%
Mbetje inerte (çmim paraprak)	500	100	400	20%
Mbetje teknologjike	2500	500	2000	20%



Gjithashtu nga kjo Kompani sugjerohet ndryshimi i tarifës së akomodimit tarifë që shkon në favor të ndërmarrjes Ndërkomunale sha nga 15% që është sot në 20%. Pra raporti i të ardhurave të krijuara të jetë 80% në favor të Kompanisë dhe 20% në favor të Shoqërisë “Ndërkomunale Bushat sha”.

Pasi i ka studiuar të gjitha materialet e paraqitura nga kjo Kompani, Shoqëria “Ndërkomunale Bushat sha” gjykon që kërkesa është e drejtë dhe e argumentuar saktë në terma ligjorë dhe shifra ekonomike dhe vendosi ti drejtohet Këshillit bashkiak si organ legjitim për miratimin si më poshtë:

1. Rritjen e tarifës së shërbimit në lanfill sipas tabelës referuar me sipër.
2. Miratimi për krijimin e një landfillli të ri brenda zonës së miratuar prej 23 ha si vend depozitimit i mbeturinave inerte dhe të tarifës së shërbimit për to, si dhe hartimi i studimit të fisibilitetit dhe projektit për këtë qëllim. Gjithashtu sigurimin e fondeve për zbatimin e këtij projekti.
3. Miratimin për shërbimin e depozitimit të mbeturinave teknologjike të llojeve të ndryshme dhe të tarifës së shërbimit për to si dhe hartimi i studimit të fisibilitetit dhe projektit për këtë qëllim. Gjithashtu sigurimin e fondeve për zbatimin e këtij projekti.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË “NDËRKOMUNALE BUSHAT”SHA

Agron ÇEKA

